

82).

Prindi i mirë u bë shkaktar që pasuria e tyre mbeti nën mbrojtjen dhe kujdesin e All-llahut të Madhëruar.

Nga teksti shihet se babai i tyre ishte njeri i devotshëm dhe fisnik.

Po, motra ime dhe nënë e dashur, ajeti argumenton qartë se All-llahu [subhanehu ve tealà] e mbron dhe e vë nën kujdes të tij njeriun e mirë (të devotshëm) e me të edhe fëmijët e tij, edhe në qoftë se janë larg.

Transmetom Xhabiri [radijall-llahu anhu] se i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: "All-llahu i Madhëruar me mirësinë e ndonjë njeriu mëshiron (kujdeset) fëmijët e tij si dhe fëmijët e fëmijëve të tij, familjen e fqinjëve dhe familjen e fqinjëve që janë rreth tij dhe nën kujdesin e All-llahut mbesin përderrisa ai të jetë në mesin e tyre."

Transmeton Ibën Merdevejhi nga Ibën Abbasi

Seid bin El-Musejjebi [radijall-llahu anhu] thotë: "Kur unë jam duke u falë në namaz, dhe më kujtohet fëmija im (evladi), gëzohem dhe vazhdoj edhe më shumë të falem."

Është transmetuar se All-llahu i Madhëruar vë nën kujdesin e Tij shtatë brezat e njeriut të mirë. Këtë e argumenton edhe fjala e Tij:

"Mbrotësi im është All-llahu që zbriti librin. Ai kujdeset për të mirët." (El-A'rafë: 196).

Fahrudin Er-Raziu [radijall-llahu anhu] thotë: "...dhe babai i tyre ka qenë njeri i mirë..." ajeti argumenton se mirësia e

Klubi studentor

prindërve u bën dobi fëmijëve të tyre si dhe bëhet shkak për kujdesin e All-llahut [subhanehu ve tealà].

Ibën Kethiri [radijall-llahu anhu] thotë: "Në të ka argument se njeriut të mirë i vihet nën kujdes familja e tij, edhe atë me bereqetin e ibadetit të tij në këtë dhe në botën tjetër: duke u lutur për ta, duke ndër-mjetësuar tek All-llahu [subhanehu ve tealà] për ta, duke i ngritur lart në shkallët e Xhennetit dhe duke mbetur të gëzuar së bashku me ta".

Kështu motra ime garantohet ardhmëria e fëmijëve tanë me mirësinë e prindërve. Sa fëmijë trashëgjuan nga prindërit e tyre pasuri të panumërta, e që më vonë i humbën dhe jetuan të varfër, e sa të tjerë nuk trashëgjuan ndoshta asgjë nga pasuritë e prindërve të tyre, mirëpo me mirësinë e baballarëve dhe nënave të tyre hasën në bereqet të gjërë dhe jetuan si të pasur?!

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



Më i Madh se çdo gjë!



het tepër kur i ka ato dhe dëshpërohet tepër kur nuk i ka ato.

5. Besimtari e di se të mirat e kësaj bote janë të ndryshueshme, shpejt ndërrohen, andaj edhe nuk i konsideron gjëra me peshë në zemrën e tij.

Pabesimtari ndaj kësaj çështje është gafil, andaj edhe e vulos zemrën e tij në të mirat e kësaj bote. I përqafton të njëjtat me përqaftim, me të cilin i dashuruari përqafton të dashurën e tij, që kur i humben apo mbarojnë, zemra i digjet, ndërsa fatëkeqësia bëhet edhe më e madhe me humbjen e tyre. (Fahrudin er-Razi "Et-Tefsir El-Kebir" 20/113).

Motra ime e dashur, ajetin e lartëpërmendur dhe premtimin bujar i cili njëherit është i vërtetuar edhe me tre gjëra vërtetuese, dhe atë:

a) Me pjesëzën e cila quhet: Lamu-l-kasem- lami betues (betohem se...), të cilin e hasim në fillim të ajetit të lartëshënuar: "Ne do t'i japim atij (betohem se do t'i japim atij)..."

b) Nunu-te'kid- Nuni vërtetues (me të vërtetë...). Ai nuk thotë vetëm se do t'i japim, por, me të vërtetë...!

c) Objekti akuzativ - "Jetë ...".

Ndoshta ndonjëra prej jush do të më thotë se premtimi i tillë ka të bëjë

Klubi studentor

vetëm se për meshkujt e jo edhe për femrat, të cilat lodhen dhe kanë jetë plot mundime. Unë them jo, një gjë e tillë nuk është e vërtetë ngase çdo premtim në Kur'anin famëlartë përfshinë edhe mashkullin edhe femrën, e ajeti i lartëpërmendur më së miri e vërteton këtë, ku All-llahu i Madhëruar thotë: "*Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër...*".

Ky është njeherit edhe sqarim që besimtarja të jetë e qetë dhe e sigurtë se edhe **Asaj** i është e premtuar një jetë të mirë në këtë dhe në botën tjetër, dhe se premtimi nuk është i kufizuar vetëm për meshkujt.

Andaj, motra ime, a nuk do të veprosh më shumë të mira... që të arrishë fitoren e jetës së mirë... në dynja dhe në ahiret!?

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



Jetë të mirë... në dynja dhe në ahiret

Motra ime e dashur, a di se sa here në ditë e përsëritë apo e dëgjon fjalën: **"ALL-LLAHU EKBER?"**

Në dy reqatet e sabahut këtë fjalë e përsëritë 10 herë, në namazin e akshamit, në 3 reqatet e saja 16 herë, dhe në reqatet të drekës, ikindisë dhe jacisë e përsëritë 22 herë. Po qe se i mbledh të gjitha në pesë namazet e falura, ato bëjnë 92 herë, edhe ate vetëm në namazet e caktuara (farz), ngase po numërojmë edhe reqatet e vitrit dhe sunnetet, atëherë numri arrinë në 200.

Po qe se vepron sipas sunnetit të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], atëherë pas çdo namazi ti thua 33 herë All-llahu ekber, apo 165 tekbire në ditë. Kështu numri i fjalës së përsëritur në ditë arrin 350 herë. Po qe se vazhdojmë të numërojmë edhe 30 tekbiret të cilat për çdo ditë i dëgjojmë nëpër ezanet e xhamive si dhe 20 tekbiret në çdo ikamet të namazeve, atëherë fjala All-llahu ekber, të cilën e thua apo e dëgjon, ngel e përsëritur më se 400 herë për çdo ditë.

A vëren motra ime e dashur?- më shumë se 400 herë për çdo ditë, gjuha jote shqipton apo veshi yt e dëgjon fjalën: "All-llahu ekber".

Andaj, pas gjithë kësaj përse brengoseh, apo frikohesh, përse ndjen shqetësim dhe dobësohesh?

Si frikohesh nga njeriu, sa do që të jetë i fuqishëm ai kur e di se All-llahu i Madhëruar është më i fuqishmi dhe më i Madhi?!

Si frikohesh nga fatëkeqësia që të godet, kur ti beson se All-llahu [subhanehu

ve teal] është më i madh dhe më i fuqishëm se fatëkeqësitë që të kanë goditur, dhe se vetëm Ai posedon fuqi që t'i largojë nga ti fatëkeqësitë e tilla?!

Përse brengosesh për shkak të shqetësimeve, kur e di se All-llahu [subhanehu ve teal] është më i madh se të gjitha shqetësimet dhe brengat e dynjasë?!

Si dobësohesh, kur ti je e bindur se vetëm All-llahu [subhanehu ve teal] është më i madh se çdo gjë dhe më i fuqishëm se çdo fuqi?!

Si dështon, kur ti je e bindur se vetëm All-llahu [subhanehu ve teal] është Ai i cili ndihmon?!

Motra ime, përkujto se ti gjithmonë, e përsëritë apo e dëgjon fjalën "All-llahu ekber", se Ai është më i madh se çdo gjë, më i fuqishëm se çdo fuqi dhe më i mëshirshëm se çdo mëshirë.

"Është e vërtetë se njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm. Pse kur e godet ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi. Ndërkaq, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprrac. Përveç atyre që falen. Të cilët janë të rregullt në faljen e namazit të tyre." (El-Mearixh:19-23).

Ata janë ata, të cilët në namazin e tyre janë të rregullt në lidhje të përhershme me All-llahun e tyre, të qetë dhe të sigurtë se janë të mbështetur në Te, të qetë se janë të drejtuar vetëm kah Ai dhe të kënaqur kur janë para duarve të Tij.

Motra ime e dashur, sa e kënaqur dhe e gëzuar do të jesh me imanin tënd, sa e lumtur do të jesh me namazin tënd.

Motra ime e dashur, a dëshiron që jeta yte të jetë e mirë, a dëshiron të jesh e qetë dhe e gëzuar, e lumtur dhe e buzëqeshur, e kënaqur?

Nuk dyshoj dot, se në këte dikush do të thoshte jo. Pra të gjithë do të thonin: "Po, po." Këte edhe e shpresoj që ta thoni, bile kjo është e tëra të cilën e shpresoj nga ju.

All-llahu i Madhëruar thotë:

"Kush bën veprë të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre." (En-Nahël: 97).

A nuk vëren pra motra ime, premtimin e All-llahut [subhanehu ve teal] bujar: "...Ne do t'i japim atij jetë të mirë (në këtë botë)...".

Me siguri do të thuash: "Por kjo është premtim për botën tjetër (ahiretin)".

Unë të them: Premtimi i tillë është për këtë botë, ngase për ahiretin shprehet në pjesën tjetër të ajetit të ndershëm duke thenë: "...e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre."

Ndoshta më pyet, motra ime e

çmuar, se, a do të thotë "jetë e mirë" gjithë **Ajo** që në fillim e cekët në fjalimin tuaj?

Unë them: "Po, gjithsesi, po bile edhe më shumë. Komentatorët e Kur'anit famëlartë shënuan shumë gjëra me të cilat do të mund të fitosh jetë të mirë. Ata për jetën e mirë thonë: "Me rrizkun hallall, me fitimin e pastër, me lumturi me atë që e ke, me ëmbëlsinë e përlujës (et-ta'ah) dhe me pavarësi nga njerëzit (të mos jesh i varur nga të tjerët).

Fahrudin Er-Raziu [rahimehull-llah] thotë: "Dije, se jeta e besimtarit në dynja është më e mirë se jeta e pabesimtarit për shumë shkaqe:

1. Besimtari beson se rrizku i tij arrin me caktimin e All-llahut [subhanehu ve teal], si dhe beson se Ai është Bamirës, Bujar dhe nuk bën tjetër pos të mirën. Me këte ai bëhet i kënaqur në çdo caktim të All-llahut [subhanehu ve teal] (kada dhe kader) dhe bëhet i bindur se çdo gjë është për të mirën e tij.

Pabesimtari nuk i njeh dot këto gjëra, andaj, edhe e hasim gjithmonë në mjerim dhe shqetësim.

2. Besimtari gjithmonë në kokën e tij ka ndërmend llojet e sprovave dhe fatëkeqësive dhe po qe se ndonjë e

Ku është thesari

Ajo i tha asaj: Përse të shoh të bren-gosur?

Ajo u përgjigj: Të gjitha shoqet e mia dhe të afërmit e mi kanë garantuar ardhmërinë e fëmijëve të tyre... pos unë!

Ajo e pyeti: Si e kanë garantuar ata ardhmërinë e tyre?

Ajo tha: Disa prej tyre kanë bërë për çdonjërin nga një shtëpi, e disa prej tyre kanë lënë të holla të gatshme, e disa u kanë shkruar qysh testamentë në emër të tyre, vende të pasura dhe të patundshme... ndërsa unë nuk kam asgjë për t'u lënë..., paga mujore e babait të tyre nuk arrin bile as aq sa të na mjaftojë.

Ajo tha: Motra ime, a mendon ti se kjo është garancë e ardhmërisë së tyre? Ky është mendim i gabuar. Po, është mirë që nëna ti le fëmijët e saj të pasur e që assesi të mos i le që ta shtrijnë dorën për të kërkuar prej të tjerëve... por, prapëseprapë kjo nuk është garancë për ta.

Ajo e pyeti: Po si pra?

Ajo tha: All-llahu i Madhëruar në librin e Tij fisnik flet mbi jetimat të cilëve All-llahu [subhanehu ve teal] ua mbrojti thesarin e fshehur nga babai i tyre, vetëm e vetëm se babai i tyre ishte njeri i mirë. Ai thotë:

"Përsa i përket murit, ai ishte i dy djelmohave jetimë të atij qyteti, e nën të ata kishin një thesar (ari) dhe babai i tyre ka qenë njeri i mirë, e Zoti yt dëshiroi që ata dy (djemtë) të arrijnë pjekurinë e vet dhe ta nxjerrin ata vetë thesarin e tyre. Kjo ishte mëshirë e Zotit tënd (ndaj tyre)." (El-Kehf:

godet, ai mbetet i kënaqur me caktimin e All-llahut [subhanehu ve teal], gjë e cila është obligim (vaxhib). Besimtari nuk i zmadhon fatëkeqësitë që ndodhin.

Pabesimtari nuk është kështu, sepse ai nuk ka parasysh këtë parim të besimit, andaj kur e godet ndonjë fatëkeqësi zemra e tij mbushet me shqetësim dhe brengë.

3. Zemra e besimtarit është e mbushur me dritën (nurin) e njohjes së All-llahut të Madhëruar, dhe kur zemra është e mbushur me njohje të tillë, nuk le vend për brengat që mundohen ta godasin atë për shkak të ngjarjeve (fatëkeqësive) të kësaj bote.

Zemra e pabesimtarit është e zbrazët nga njohja e All-llahut të Madhëruar, andaj nuk është habi kur e shohim të mbushur me brenga dhe shqetësime për shkak të fatëkeqësive të kësaj bote.

4. Besimtari e di se fizike janë të kufizuara dhe pa vlerë të madhe, andaj edhe nuk gëzohet tepër kur janë bollëk, por as nuk dëshpërohet kur të mirat e kësaj bote nuk arrijnë tek ai.

Pabesimtari nuk njeh dot kënaqësi tjetër pos të tyre... andaj edhe gëzo-